



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 97, datë 21.06.2019

**PËR
PËRSËRITJEN E TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM TË GJYQTARIT
REXHEP KARAJ NË GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS**

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, i ndryshuar, në vendimin nr. 88, datë 17.06.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe duke mbajtur në konsiderate dhënien e pëlqimit të gjyqtarit Rexhep Karaj me shkresën nr. 3307, datë 20.06.2019, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Gjyqtarit Rexhep Karaj, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, deri më datë 15.09.2019.
2. Gjyqtari Rexhep Karaj të përjashtohet nga shorti gjatë periudhës së transferimit të përkohshëm, deri më datë 15.09.2019, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, me përjashtim të “çështjeve gjyqësore urgjente” në kuptim të nenit 2, shkronja “c”, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, për të cilat duhet të përfshihet në short deri më datë 31.08.2019.
3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit Rexhep Karaj, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR